

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **QENDRA E STUDENTEVE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **208/90500-26-3721-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me makinë industriale për larjen e enëve**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>E-COMPANY SH.P.K.</b>
NUI	<b>810734245</b>
Adresa	<b>Xhelal Hajda - Toni</b>
Vendi	<b>Rahovec</b>
Kodi postar	<b>21000</b>
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Ardian Osa</b>
Adresa elektronike	<b>ecompanyntp@gmail.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>11.06.2026</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

#### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**Furnizim me makinë industriale për larjen e enëve**

**B05 Njoftim për Kontratë publikuar në e-prokurim me datë 22.05.2026**

**Shqarim shtesë publikuar me date 02.06.2026 në ora 14:47**

**Kërka për rishqyrtim është dorzuar me date 06.06.2026 në ora 17:15**

**Vendimi për pezullim pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim, nuk është marë.**

**Vendimi në kërkesë për rishqyrtim është publikuar me date 08.06.2026 ora 12:53**

#### **4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet**

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po

Jo

#### **5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

Jo

#### **6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po

Jo

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

**Me datën 06.06.2026 kemi dorzuar kërkesë për rishqyrtim dhe me datën 08.06.2026**

**AK e ka refuzuar kërkesën tone duke e hedhur si të jashtëafateshme.**

#### **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e*

*Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 5 Kalkulimi I afateve kohore  
Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve  
Neni 109 Afatet për Dorëzimin e Ankesës  
Neni 42.7 të RRPP Nr 002/2024.  
Neni 60 të RRPP Nr 002/2024.

Kërkesa ë rishqyrtim ishte parashtruar për shkeljet ne dispozitat e poshtë listuara.

Neni 1 Qëllimi  
Neni 2 Fushëveprimi  
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti  
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi  
Neni 28 Specifikimet teknike  
Neni 29 Variantet e specifikimeve teknike  
Neni 32 Rregullat e Përgjithshme  
Nenit 17.17 të Rregullores për Prokurimin Publik Nr. 001/2022 (e konsoliduar me Nr. 002/2024) Dosja e tenderit nuk duhet të kufizojë konkurrencën ose të diskriminojë OE-të;  
Nenit 17.22.1 të RRPP Kërkesat obligative për specifikimet teknike të furnizimeve.

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

1. Parashtruesi i kësaj kërkesë për rishqyrtim është operator ekonomik i regjistruar, aktiv në fushën e furnizimit me pajisje industriale, dhe si i tillë ka interes të drejtpërdrejtë dhe legjitim për të marrë pjesë në këtë aktivitet prokurimi. Parashtruesi kualifikohet si "palë e interesuar" sipas nenit 4, paragrafi 1.25 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (LPP).
- 2.
3. BAZA LIGJORE
- 4.
5. Kjo kërkesë për rishqyrtim parashtrohet në mbështetje të Nenit 108/A të LPP (Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar me ligjet Nr. 04/L-237, Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L-092) – Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve;
- 6.
7. Bazuar ne faktet qe do te paraqiten ne kete kerkes per rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundershtim me dispozitat ligjore te parapara me LPP dhe Rregulloreneve fuqi qe mbulojne prokurimin publike.

- 8.
9. Ne vazhdim do ti shpalojmë të gjitha faktet dhe argumentet që mbështesin këtë kërkesë tënde.

1. Autoriteti kontraktues nuk e ka shqyrtuar kërkesën tënde për rishqyrtim me pretendimin se kërkesa për rishqyrtim ishte jashtë-afatshme.

- Në arsyetimin e vendimit AK ka arsyetuar si më poshtë:  
Sipas pretendimeve të AK, ne kemi dorëzuar kërkesën jashtë afatit të parapara me legjislacionin në fuqi dhe atë në kundërshtim me Nenin 60 paragrafi 1 pika (b) dhe paragrafi 2 lidhur me nenin 42.7 të rregullares Nr 002/2024 për prokurim publik

- Bazuar në këtë AK ka interpretuar gabimisht legjislacionin në fuqi dhe Rregulloren nr 002/2024 për prokurim publik pasi që

a. Ka marrë vendim bazuar në Nenin 60 paragrafi 1 pika (b) që ka të bëjë me citojmë “Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënienë të një kontratë” ndërsa ne kemi bërë kërkesë për rishqyrtim për njoftimin për kontratë e që trajtohet në pikën (a) të po kësaj neni

b. Bazuar në nenin 60.1 pika (a) citojmë “Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave. Në kalkulimin të afatit kohorë dita e dorëzimit të ofertave është dita (0).

Bazuar në interpretimin ligjorë I datës 04.12.2023 me nr 35 të leshuar në KRPP kalkulimi I afatit citojmë “1. Në përputhje me nenin 60.1, a) të RRPP, në rast se AK ka publikuar Njoftimin për Kontratë, dita e fundit e dorëzimit të ofertave është dita “zero” e pesë ditëve të afatit ankimor në AK dhe ky afat fillon të kullohet në mënyrë retroaktive. Për shembull: Nëse Njoftimi për Kontratë apo dokumentet e tenderit janë publikuar (janë ngritur në sistem) me datë 05.10.2023 ndërsa afati i fundit për dorëzimin e ofertave është caktuar me datë 15.11.2023. Afati fillon të kullohet në mënyrë retroaktive duke filluar nga dita e dorëzimit të ofertave: 14, 13, 12, 11, 10 dhe rrjedhimisht afati i fundit kur një OE mund të paraqet kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së është data 09.11.2023 deri në orë 16:00. Pra në këtë rast, OE mund të paraqet kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë e deri me datë 09.11.2023 para orës 16:00.

Nëse bëjmë numrimin e ditëve bazuar në nenin 60.1 pika (a) dhe interpretimin ligjorë nr 35 atëherë ne kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim Brenda afatit të parapara në këtë rregullore.

Data e fundit për dorëzimin e ofertave është 12.06.2026 është dita 0

Data 11.06.2026 eshte dita 1  
Data 10.06.2026 eshte dita 2  
Data 09.06.2026 eshte dita 3  
Data 08.06.2026 eshte dita 4  
Data 07.06.2026 eshte dita 5  
Data 06.06.2026 ( e shtune) eshte dita 6 kjo eshte dita kur ne e kemi dorzuar kerkesen per rishqyrtim.

Bazuar ne Paragrafi 2 te nenit 5 Kalkulimi I afateve kohore citojme: "Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj"

Pasi qe dita 06.06.2026 eshte dite e shtune dhe eshte dita e fundit e afatit per dorzim te kerkeses per rishqyrtim ateher ne kuptim te nenin 5 paragarfi 2 I bije se dita e fundit per dorzim te kerkeses per rishqyrtim eshte dita e pare e punes e cila eshte dita e Hene data 08.06.2026.

Autoriteti kontraktues meveprimet e veta do tendikojë drejtperdrejt nekundershtim te nenit 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti ku me kufizim te konkuresces por edhe te paracaktimit te furnizotirit do te ndikojë drejtperdrejt ne ritjen e cmimit te furnizimit dhene kete menyre do te demtoje buxhetin e R. Kosoves.

A utoriteti kontraktues eshte ne kundershhtim me neni 7 te LPP pasi me vendosjen e kerkesave te listuara me porshite por edhe specifikacioneve teknike te detyrueshme ne menyre te drejtperdrejt ka ndikuar ne faovorizimi te nje kompanije te vetme dhe nuk po na tjartone ne menyre te barabarte dhe po na diskreminon ne kete aktivitet te porkurimit.

Autoriteti kontraktues me veprimet e veta ne pergaditjen e specifikave nuk ka lejuar variantet e specifikave dhe keshu ka bere shkelje te nenit 29 te LPP

## 2. KAPACITETI TEKNIK DHE PROFESSIONAL

Kërkesa 2 Operatori ekonomik duhet të ofroj autorizimin nga prodhuesi për të gjithë artikujt e përfshirë në këtë aktivitet të prokurimit.

ishmia 2 Autorizimin nga prodhuesi. Autorizimi përveç tjerash duhet të përfshijë modelin e pajisjes, kodet përkatëse të artikujve dhe numrin e prokurimit të këtij aktiviteti të prokurimit. Autorizimi duhet të jetë valid I skanuar nga Origjinali (nëpërmes e-prokurimit në formë elektronike).

Me ane te kesaj kerkese specifike AK ndikone drejtperdrejt ne rezultatin e ketije aktiviteti te prokurimit respektivishte kompanin ciles do ti jepet kjo kontrate. Kjo kërkesë është diskriminuese për arsyet e mëposhtme:

Asnjë prodhues nuk lëshon autorizim duke përfshirë modelin e pajisjes, kodet përkatëse të artikujve dhe numrin e prokurimit të këtij aktiviteti të prokurimit kjo është e pamundur për tu realizuar

Kombinimi i "modelit të pajisjes kodeve të artikujve numrit të prokurimit" krijon de facto një autorizim ekskluziv që vetëm distributorët e prodhuesit i cili ka diktuar specifikimet mund ta sigurojnë;

### 3. KAPACITETI TEKNIK DHE PROFESSIONAL

Kërkesa 5 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me CE Marking (Conformité Européenne)

ishmia 5 CE Certificate CE Marking

Me anë të kësaj kërkesë autoriteti kontraktues e ka keqinterpretuar legjislacionin sa i përket LPP por edhe ligjet në fushën e standartzimit të produkteve, kjo pasi që certifikimi me CE Marking (Conformité Européenne) behet produkti respektivisht prodhuesi e jo Operatori ekonomik I cili mëre pjesë në këtë aktivitet të prokurimit. Nëse mbetet në fuqi ky kriter atëherë ky aktivitet I prokurimit, në fund, do të rezultojë me anulim pasi që këto kriter nuk do të mund të plotësojnë asnjë operator ekonomik, përjashtimisht nëse vetë prodhuesi mëre pjesë në këtë aktivitet të prokurimit.

### 4. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

#### a. Artikulljt nr 1 deri 10

Specifikacionet e kërkuara në këtë aktivitet të prokurimit sidomos artikujt me nr 1 deri në 10 janë të prodhuesit Sistem Project italia s.r.l dhe janë kërkesat specifike të cilat i plotëson vetëm ky prodhues.

Kjo deshmohet nëse mirën edhe krahasohen katalogu i prodhuesit dhe specifikimet teknike të kërkuara janë 100% të njëjta dhe asnjë prodhues tjetër nuk i plotëson kërkesat specifike.

Në industrinë e lavastovileve në Europë po edhe më gjërë ka një numër të konsiderueshëm të prodhuesve të cilët prodhojnë lavastovile me kualitet dhe kapacitet më të mirë se sa ky prodhues i për zgjedhur, por për faktin që në specifikat teknike shumë specifike duke mos lënë tolerancë tregojnë se njësia kërkuarë vetëm se e ka për zgjedhur fituesin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Si deshmë që AK kërkesat për specifikat teknike ka përdorur kodet e po të njëjtit prodhues si përsh: CTRC, CTAF, CTDD, CTTA, CTABT dhe CTX që bazuar në LPP dhe Rregulloret në fuqi është e ndaluar. - Të bashkëgjitur e keni katalogun e prodhuesit ku mund të bindeni se specifikat janë të njëjtat me specifikat e kërkuara

b. Artikulli nr 11

Makinë profesionale full automatike për prodhimin e petëve, full inox , makina përdorë ngrohje elektrike për të shtypur dhe për të bërë petë, të këtë kontrolluesin e temperatures digjital 800-1000pcs/h, dimensionet 750x630x145cm, 220v-380v, 3.5kw, diametri i petëve minimum 40cm, pesha totale 95kg, pneumatik cilinder, separator uji.

Nese bazohemi ne pershkrim Makine profesionale full automatike per prodhimin e peteve neve si OE na vendos ne hamendje se cka nenkupton me "full automatike pasi qe gjate fazes se implementimit mund te shkaktoje probleme.

Ne kerkes per shqarim shtes te kerkuar nga nje operatore tjeter ekonomik,te jap informata shtes lidhur me kete pajisje por nuk I eshte pergjigjur.

AK duhet dhene shqarime se qka nenkupton full automatike.

Ne kuptim te linjave te prodhimit fjala FULL AUTOMATIKE I bije se linja e bene komplet prodhimin nga marja e lendes se pare (millin, ujin, kirpen, melmesat, etj), bene dozimin e tyre, perzierjen ne mikser, pas perzierjes se brumit me konvejer e barte deri te makina per ndarjen e brumit ne Madhesi te caktuar apo peshe, pataj bene rrumbullakosjen ne forme te topave, transportohet te makina qe bene hapjen e petes, pjekjen ( tharejn) dhe vendosjen ne nje ene te caktuar. E gjitha kjo pa pjesmarjen e puntorit. Ne nje pershkrim te shkurt ky eshte kuptimi I fjales full automatike.

Prandaj duhet shqaruar specifikat teknike dhe te precizohen keto detalet.

Pas gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara kerkojme dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdese ankesë tonë dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar, duke marrë:

**V E N D I M**

**APROVOHET** si e bazuar ankesa e OE E-COMPANY SHPK lidhur me kete tenderin

**ANULOHET** vendimi i dates 08.06.2026 i autoritetit kontraktues Qendra e Studenteve per hedhjen si te jashteafatshme kerkesen per rishqyrtim, ta ktheje ne rivendosje.

Te obligoje AK qe te ndryshimet e duhura dhe ta rishpalle kete aktivitet te prokurimit në dispozitat e LPPsë, dhe në interpretimet e KRPP-së.

## **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Neve si Ofertues në këtë aktivitet të prokurimit kemi shpenzime të konsiderueshme për perpilimin e kërkesës për rishqyrtim të vendimit në AK në përgatitjen e dokumentacionit të ankeses ne OSHP dhe pjesëve të tjera të cilat ndërlidhen me këtë procedurë të prokurimit ashtu edhe në fitimin e humbur si pasojë direkte e vlerësimit diskriminues në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe akteve tjera nënligjore ,dhe interpretimin e neneve përkatëse nga ana e ekspertëve të KRPP-së.**

**Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo-material e i cili shtrihet edhe në raport neni 136 dhe Neni 137 të LMD-së duke mos u kufizuar edhe në dëmin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.**

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*